



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.518, datë 21.12.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME
BERAT-KUÇOVË SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 21.12.2021 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a.",

Vëren se:

1. Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë me shkresën nr.1524 prot., datë 10.12.2021, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit - grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit - largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Berat-Kuçovë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 63

datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (*VKM nr. 63*).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria UK Berat-Kuçovë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 132 163 banorë të Bashkisë Berat-Kuçovë;
- b) Drejtuesja teknik znj. Aleksandra Kllapi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i inxhinierisë së Ndërtimit dega Hidroteknike në vitin 1986 dhe ka mbi 5 vite përvojë në profesion;

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Berat-Kuçovë, të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (*ligji nr. 9121*) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Berat-Kuçovë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a me (NUIS J62903166T), në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues Ligjor – Pelivan Sinaj
 - b) Drejtuese Teknike – Aleksandra Kllapi

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a është Bashkia Berat-Kuçovë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani